



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.358, datë 16.11.2021

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në kërkesën për dorëheqje nga detyra të znj. Ermira Tafani, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 2230 prot, datë 26.10.2021, me propozim të Komisionit Për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje për **Znj. Ermira Tafani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.
2. Dorëheqja jep efekt më datë 30.11.2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Ermira Tafani, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
MOISI DUDA

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ